

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00 Nr.58 /2022	Data: 29.04.2022	

Kuvendi i Komunës, në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe 12.2, pika d), nenit 14 dhe nenit 40, paragrafi 40.2, pika L) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; nenit 53 dhe 57 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative; nenit 27 paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 16, paragrafi 2 të kontratës Nr. 407/2018 të datës 16.07.2018, në mbledhjen e mbajtur më 29.04.2022 të miratojë këtë:

V E N D I M
PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS
01 NR.27/2018 të datës 29.03.2018

- MIRATOHET** shfuqizimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës 01 Nr.27/2018 i datës 29.03.2018 sipas të cilit ishte dhënë në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite përmes ankandit publik qiramarrësit “ Te Aleni” Njësia Kadastrale P-70806008-00074-11, me sipërfaqe të përgjithshme prej 25023 m², në vendin e quajtur “ Fusha e Gjveshur “, pjesa e pronës 1/1, Zona Kadastrale-Vrellë e cila sipas certifikatës pronësore evidentohet pronë shoqërore-shfrytëzues e mirë e fshatit Vrellë, me qëllim të shfrytëzimit të gurit gëlqeror për prodhimin e rërës për ndërtim.
- Ky Vendim hynë në fuqi 15 (pesëmbëdhjete) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit të tij në faqen zyrtare të Komunës.
- Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset: Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, Drejtoria e Inspektionit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Arsyetim

Sipas Vendimit 01 Nr.27/2018 të miratuar më 29.03.2018 nga Kuvendi i Komunës, Njësia Kadastrale P-70806008-00074-11, me sipërfaqe të përgjithshme prej 25023 m², Zona Kadastrale-Vrellë e cila sipas certifikatës pronësore evidentohet pronë shoqërore-shfrytëzues e mirë e fshatit Vrellë ishte dhënë në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite përmes ankandit publik të shpallur më 22.05.2018, qiramarrësit “ Te Aleni” me qëllim të shfrytëzimit të gurit gëlqeror për prodhimin e rërës për ndërtim.

Dhënia në shfrytëzim e Njesisë Kadastrale të lartcekur qimarrësit " Te Aleni" ishte bërë në bazë të çmimit me të lartë të ofertuar në këtë ankand publik sipas Komisionit Komunal Vlerësues të ofertave për dhënien në shfrytëzim të Pronës së komunës, përkatësisht sipas Vlerësimit 01 Nr.62/2018 të datës 22.06.2018 për hapjen e ofertave dhe shpalljes së fituesit " Te Aleni" sipas ofertës më të volitshme të ofruar. Komisioni Komunal Vlerësues i ofertave për dhënien në shfrytëzim të Pronës ishte themeluar sipas vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.19/2018 të datës 29.03.2018.

Pas shpalljes fitues të qiramarrësit " Te Aleni " është lidhur kontrata Nr. 407/2018 e datës 16.07.2018 me Komunën, përkatësisht Kryetarin e Komunës si qiradhënë, në të cilën janë përcaktuar me hollësisht të drejtat dhe obligimet e qiramarrësit " Te Aleni " dhe qiradhënësit-Komunës së Istogut.

Sipas kërkesës Nr. 01-016-11513 të datës 25.03.2022 të qiramarrësit Fadil Dreshaj " Te Aleni" për shkak të skadimit të licencës së punës për shfrytëzim e gurit gëlqeror për prodhimin e rërës për ndërtim në pronën e paluajtshme të komunës Njësine Kadastrale P-70806008-00074-11 ka kërkuar shkëputjen e kontratës Nr. 407/2018.

Bazuar në arsyeshmërinë e këtij propozim-vendimi dhe nenin 27 paragrafi 5 të Rregullores Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, kërkoj nga anëtarët e Kuvendit të Komunës që i njëjti të miratohet.


REPUBLIKA E KOSOVES KOMUNA E ISTOGUT
REPUBLIKA KOSOVO OPSTINA ISTOK
DREJTORIA E ADMINISTRATES PERGJITHSHME
UPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE
Shënim: 033-37 Data 06.05.2022
Br: Datum
ISTOC-ISTOK

Kryesuesi i Kuvendit
z. Enver Rugova



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00 Br.58/2022	Datum: 29.04.2022	

Skupština opštine, na osnovu člana 12, stav 12.2, tačka d) i člana 14 Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi; Član 53 i 54 stav 1 podstav 1.2 Zakona Br. 05/L-031 za opšti upravni postupak; Član 27 stav 5 i 6 Uredbe br. 09/2020 o utvrđivanju procedure za davanje u zakup na korišćenje i zamenu nepokretnosti opštine i član 16. stav 2. ugovora br. 407/2018 od 16.07.2018. godine, na sastanku održanom 29.04.2022 usvaja:

**ODLUKU
ZA PONIŠTAVANJE ODLUKE SKUPŠTINE OPŠTINE
01 BR.27/2021 DATUMA 29.03.2018**

- USVAJA SE** poništavanje Odluke Skupštine opštine 01 Br. 27/2018 usvojene 29.03.2018 prema kojem je dat na kratkotrajno korišćenje, na 15 godina, putem javnog nadmetanja, zakupcu "Te Aleni", katastarska jedinica P-70806008-00074-11, ukupne površine 25023 m², u z. mesto zvano "Fusha e Gjveshur" "", deo imovine 1/1, katastarska zona-Vrela, koja je prema imovinskom listu, evidentirana kao dobra društveno-korisnička imovina sela Vrela, za korišćenje krečnjaka, za proizvodnju peska za građevinarstvo.
- Ova Odluka stupa na snagu 15 (petnaest) dana od dana registracije u kancelariji za protokol Ministarstva nadležnog za poslove lokalne samouprave, i 7 (sedam) dana od dana objavljivanja na zvaničnoj internet stranici Opštine.
- O sprovođenju ove Odluke staraju se: Kancelarija Predsednika, Direkcija za katastar i geodeziju i Direkcija za urbanizam i prostorno planiranje, Direkcija za Inspekciju i Direkcija za Budžet i Finansije.

Obrazloženje

Odlukom 01 br. 27/2018, usvojenom 29.03.2018 godine, od strane Skupštine opštine, katastarska jedinica P-70806008-00074-11, ukupne površine 25023 m², katastarska zona-Vrela, koja je prema r. imovinski list, evidentira kao dobro društveno-korisnička imovina sela Vrele, dat je na kratkoročno korišćenje na 15 godina, putem javne aukcije, objavljene 22.05.2018. godine, zakupci "Te Aleni", kako bi koristili krečnjak, za proizvodnju peska za gradnju.

Davanje na korišćenje gore pomenute katastarske jedinice, zakupac „Te Aleni“, izvršeno je na osnovu najviše ponuđene cene na ovoj javnoj licitaciji, prema opštinskoj komisiji za procenu ponuda, za puštanje u rad opštinske imovine, odnosno prema proceni. 01 br. 62/2018 od 22.06.2018.godine za otvaranje ponuda i proglašenje pobednika „Te Aleni“, po najpovoljnijoj ponuđenoj ponudi. Opštinska komisija za procenu ponuda za korišćenje imovine osnovana je odlukom Skupštine opštine br. 19/2018 od 29.03.2018.

Nakon proglašenja pobednika, zakupca "Te Aleni", potpisan je ugovor br. 407/2018, od 16.07.2018.godine sa Opštinom, odnosno Gradonačelnikom kao zakupodavcem, u kojem su detaljno definisana prava i obaveze zakupca „Te Aleni“, i zakupodavca-Opština Istok.

Prema zahtevu br. 01-016-11513 od 25.03.2022.godine zakupca Fadila Dreshaja „Te Aleni“ zbog isteka dozvole za rad za korišćenje krečnjaka za proizvodnju peska za gradnju u nepokretnosti opštine KJ P-70806008 -00074 -11 je zatražio raskid ugovora br. 407/2018.

Na osnovu razumnosti ovog nacрта odluke i člana 27. stav 5. Uredbe br. 09/2020 o utvrđivanju procedure za davanje na korišćenje i zamenu nepokretne imovine opštine, tražim od odbornika Skupštine opštine da se ista odobri

